



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE
TELEKOMUNIKACIONIT

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË

Mesazhi i Ministrit



Të nderuar qytetarë,

Plani i Integruar i Ministrisë është një dokument në të cilin përmbliidhen angazhimet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit gjatë vitit 2007, në kuadër të zhvillimit të të gjithë sektorëve të veprimtarisë së saj. Përmes këtyre angazhimeve ne do të synojmë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në Programin e Qeverisë, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimi në NATO, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2007-2009.

Hartimi i këtij plani synon të mbështesë përpjekjet tona për të arritur një zhvillim ekonomik-social që do të ndikonte në përmirësimin e jetës së qytetareve tanë.

Synimi kryesor i zhvillimit të sektorit të transportit është integrimi i rrjetit rrugor shqiptar në atë rajonal dhe evropian, duke përshpejtuar ritmet e zbatimit të projekteve të infrastrukturës së transportit me impakt kombëtar, rritjen e standarteve të sigurisë rrugore, përmirësimin e kushteve që do të mundësonin lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave.

Decentralizimi dhe komercializimi i sektorit të ujësjellës-kanalizimeve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit në këtë fushë do të jenë një tjetër drejtim i rëndësishëm ku do të fokusohet puna jone gjatë vitit 2007.

Po ashtu hapja e tregut të telekomunikacioneve dhe të teknologjisë së informacionit do t'i hapë rrugën rritjes së investimeve private në këtë sektor, rritjes së aksesit në shërbime dhe rritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve për konsumatorët.


Hartimi i ligjit për planifikimin hapësinor në Shqipëri do të synojë përfaqësimin e integruar gjithëpërfshirës që kalon tej urbanizimit dhe menaxhimit të tokës, të cilat kanë drejtuar planifikimin në Shqipëri gjatë viteve të fundit, duke marrë parasysh çështje dhe objektiva sociale, ekonomike si dhe mjedisore. Kjo do të përfshijë koordinim domethënës sistematik vertikalisht brenda sektorit publik - ndërmjet niveleve të qeverisjes - dhe horizontalisht - ndërmjet të gjithë aktorëve të interesit në qeverisje, biznes dhe në shoqëri në tërësi.

Puna jonë do të mbështetet fuqimisht edhe në bashkëpunimin e ngushtë me donatorët e huaj dhe institucionet ndërkombëtare financiare, prezenca e të cileve ka qenë e dukshme dhe domethënëse për të gjithë sektorët e veprimtarisë së MPPTT.

Duke përfunduar, do të doja të theksoja se PIM-i i vitit 2007 është programi i parë i integruar i përgatitur nga MPPTT dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e planeve të tjera

të integruara që do të hartohen në vitet e ardhshme. Ai gjithashtu do të shërbejë si një tregues monitorimi dhe vlerësimi i punës së MPPTT gjatë vitit 2007.

Sinqerisht,



Sokol OLLDASHI

Ministër i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	4
3	Programet buxhetore të Ministrisë	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	16
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	17
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	19
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin European	21
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO	23
Aneks 5	Investimet publike	24
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	25

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit vepron mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në akte ligjore dhe nënligjore.

Objekti i veprimtarisë së Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në përbërje të strukturës së Qeverisë së Republikës së Shqipërisë është:

- Përgatitja dhe zbatimi i objektivave dhe politikës ekonomike të Qeverisë Shqiptare për zhvillimin e punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit në të gjithë elementet përbërës të tij (infrastrukturë, mjete, operim, etj), në shkallë kombëtare e ndërkombëtare;
- Hartimi i politikave të zhvillimit të punëve publike, transportit rrugor, hekurudhor, detar, ujor, ajror dhe telekomunikacion dhe ndjekja e zbatimit të e këtyre politikave në hallkat e varësisë;
- Përcaktimi i tendencave dhe prirjeve nga analizat e llojeve të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit mbi bazën e statistikave dhe sistemeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion dhe hartimi i treguesve makro-ekonomike të zhvillimit të përgjithshëm të ndërtimit dhe transportit afatshkurtër dhe afatgjatë; hartimi, zberthimi dhe ndjekja e treguesve të projekt - programeve ekonomike financiare, të investimeve, etj;
- Grumbullimi i projektplaneve vjetore të njëjësive shtetërore në varësi të saj për hartimin e projekt - programeve makro ekonomike të degës së ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit për mbikëqyrjen dhe pasqyrimin e parametrave e të treguesve të strategjive të zhvillimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Negocimi dhe bashkërendimi i punës me Ministritë e tjera dhe institucionet ndërkombëtare financiare e shtete të ndryshme për sigurimin e burimeve të financimit të domosdoshme, në mënyrë që të krijojë mundësi zhvillimi dhe harmonizimi të llojeve të ndërtimit dhe transportit, për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë së vendit, përmirësimin e lëvizjes së udhëtarëve dhe të kërkesave të transportit evropian;
- Drejtimi, menaxhimi, mbikëqyrja dhe vendosja e standarteve teknike të infrastrukturës së rrjeteve rrugore e hekurudhore, të porteve, pontileve e kalatave (në digat e hidrocentraleve) dhe aeroporteve;
- Shqyrtimi dhe propozimi i burimeve të financimit të brendshëm e të jashtëm (me donatorë të huaj) të harmonizuar me burimet ekonomike të ndërtimit dhe transportit për të mbuluar nevojën e zhvillimit të ndërtimit dhe transportit, si dhe rishpërndarja e tyre sipas fushave të ndryshme të veprimtarisë së MPPTT;
- Zhvillimi i hapësirës së iniciativës së lirë private në aktivitetet e shërbimit të llojeve të transportit, si dhe krijimi i kushteve për një konkurrencë të drejtë ndërmjet llojeve të transportit, në veçanti në transportin e udhëtarëve (autobusë, mikrobusë e taksit), nëpërmjet ndërtimit të sistemit fiskal vetëveprues e deri në hartimin e tarifave tavan, zhvillimin e konkurrencës në sistemin e liçensimit, etj;
- Hartimi i platformës së privatizimit të aktiviteteve të sektorëve përkatës strategjik, si dhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për transferimin e pronësisë shtetërore në pronë private;
- Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm ligjor, financiar dhe institucional me synim rritjen e aksesit në strehim të përballueshëm dhe të përshtatshëm me gjendjen ekonomike dhe social-shëndetësore të familjeve; dhe ruajtja dhe rritja e vlerës së stokut të banesave.
- Drejtimi dhe synimi për përmirësimin, zgjerimin dhe zhvillimin e shërbimeve të informacionit në ndërtim, transport dhe telekomunikacion për sigurimin e burimit të të dhënave të gjithanshme e të vazhdueshme për drejtimin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, për krijimin e kushteve lehtësuese të të gjithë përdoruesve dhe operuesve vendas e të huaj, si dhe të përshtatshme e të adaptueshme për t'u inkuadruar në sistemet europiane të informacionit;

- Përcaktimi dhe vendosja e standardeve për të gjithë llojet e mjeteve të transportit dhe organizimi i drejtimit e kontrollit shtetëror të sigurisë teknike në sferën e shfrytëzimit;
- Përcaktimi dhe miratimi i dokumentacionit teknik dhe ekonomik të domosdoshëm për kryerjen e procesit të transportit për të gjithë llojet e mjeteve të transportit;
- Organizimi i kontrollit ekonomik - financiar dhe administrativ në institucionet dhe njësitë ekonomike në varësi të Ministrisë;
- Hartimi i politikës së zhvillimit të burimeve njerëzore të punëve publike, transportit dhe telekomunikacionit si dhe organizimi dhe drejtimi i përgatitjes dhe kualifikimit të specialistëve në sistemin e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Zhvillimi i negocimit, kryerjes së përgatitjeve dhe nënshkrimit (me autorizim të organeve kompetente) të marrëveshjeve në fushat e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit me shtete të ndryshme, duke rregulluar marrëdhëniet ndërkombëtare në bazë të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar, si dhe i referohet rekomandimeve të Komunitetit Europian dhe të organizatave ndërkombëtare të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, në të cilët vendi aderohet dhe ndjekja e zbatimit të tyre;
- Kryerja e negocimeve për zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, si dhe përgatitja e domosdoshme për zgjerimin e aderimit të vendit në organizatat ndërkombëtare dhe ndjekja e zbatimit të tyre;
- Përgatitja e një sistem ligjor e rregullues, sipas kërkesave e standarteve Europiane;
- Përgatitja e projektligjeve dhe projektakteve nënligjore për përmirësimin e zhvillimit të llojeve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit e të shtrirjes së teknologjisë e të standardeve të reja në sferën e operimit të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, të rregullave e të standarteve të reja në fushën e teknikes së prodhimit, shërbimit e të mirëmbajtjes së mjeteve të ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit;
- Kryerja, përmirësimi dhe zhvillimi i reformës institucionale në sektorët e ndërtimit, transportit dhe telekomunikacionit, me synim transformimin e përgatitjen shkallë - shkallë të institucioneve në fjalë për të qene sa më afër standarteve evropiane.
- Hartimi i politikave kombëtare në fushën e planifikimit urban që shërbejnë si bazë në hartimin e kuadrit të plotë ligjor dhe në përmirësimin e mëtejshëm të tij. Koordinon e bashkërendon punën në fushat e tjera të ekonomisë dhe të pushtetit vendor. Ka përgjegjësinë e monitorimit, programimit dhe menaxhimit të të gjitha aktiviteteve për zbatimin e programit të Qeverisë për planifikimin territorial, duke respektuar legjislacionin në fuqi.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e planifikimit hapësinor

Drejtimet kryesore të kësaj strategjie janë:

- Miratimi i Dokumentit të Politikave të Planifikimit Hapësinor në Shqipëri
- Hartimi i ligjit të ri “Për planifikimin Hapësinor në Shqipëri”
- Hartimi i kuadrit ligjor për zbatimin e këtyre politikave
- Reformimi i bazës institucionale për zbatimin e këtyre politikave
- Hartimi i Strategjisë Sektoriale në fushën e planifikimit si dhe një Plan veprimi financiar dhe institucional i cili do të parashikojë impaktin financiar dhe institucional në zbatim të kuadrit të ri ligjor
- Realizimi i kësaj reforme duke marrë në konsideratë burimet njerëzore reale dhe mundësinë e rritjes të tyre
- Realizimi i investimeve në banesa sociale me qira dhe banesa me kosto të ulët
- Nxitja e sigurimit të ofertave të përballueshme për banesa dhe kredi hipotekore nga tregu privat
- Orientimi i ndihmës së shtetit për shtresat e varfra dhe të prekshme të shoqërisë
- Koordinimi i punës së të gjithë aktorëve për sigurimin e një mirëmbajtje të qëndrueshme të stokut të banesave
- Nxitja e zbatimit të programeve të ripërteritjes urbane dhe modernizimit përmirësimit të banesave, nëpërmjet partneriteteve shumë-palëshe

Strategjia sektoriale e ujit

Synohet përfundimi i procesit të decentralizimit dhe komercializimit të këtij sektori, me synim përmirësimin e rezultateve komerciale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujës-jellësve, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit në këtë fushë.

Strategjia sektoriale e transportit

Ajo ka për synim zbatimin e rekomandimeve të Masterplanit Kombëtar për Transportin, si dhe udhëzimet dhe politikat e Bashkimit Evropian. Përafrimi i legjislacionit shqiptar në këto drejtime me atë të BE do të vazhdojë të jetë objekt i veprimtarisë së MPPTT. Në këtë mënyrë, do të sigurohen kapacitetet administrative për përmbushjen e kërkesave të MSA-së dhe do të shënohet progres në transpozimin e direktivave të përafrimit të ri e të vjetër.

Strategjia ndërsektoriale e teknologjisë së informatikës, komunikimit dhe telekomunikacioneve

Kjo strategji synon hapjen e tregut të telekomunikacioneve dhe të teknologjisë së informacionit, që do t'i hapë rrugën rritjes së investimeve private në këtë sektor, rritjes së aksesit në shërbime dhe rritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve për konsumatorët.

Draftet e Strategjive Sektoriale të Planifikimit Urban, Ujit, dhe Transportit janë përgatitur dhe janë në procesin e rishikimit nga ekspertet perkates dhe nga Grupet Këshillimore të ngritura për këto qëllim, pas rekomandimeve dhe komenteve të ardhura nga Këshilli i Ministrave. Edhe Strategjia Ndersektoriale e Teknologjisë IKT është në fazën e marrjes së komenteve dhe sygjërimeve të eksperteve nga të gjitha Ministrat e linjes, të përfshira në këtë proces.

Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- **Rrugët nacionale:** Zhvillimi i një strategjie që nxit integrimin e rrjetit rrugor shqiptar në atë rajonal dhe evropian. Ndertimi i Korridoreve Kombëtare Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim (Korridori 8-te), si dhe i rrugës Durrës-Kukës-Morinë, me të gjithë standartet ndërkombëtare, deri në qershor të vitit 2009 (në varesi të ecurisë së financimit të huaj). Venia në eficiency të plotë e rrugëve turistike, si dhe rrugës me të rëndësishme turistike të bregdetit Jug-Perëndimor të vendit Vlorë-Himare-Sarandë, me synim deri në vitin 2012. Ndertimi i segmenteve që lidhin rrugët me pikat e kalimit kufitar, përfshirë dhe aksin me të rëndësishëm Tiranë-Klos-Bllatë (rruga e Arberit), me synim deri në vitin 2012 (në varesi të financimit). Përmirësimi i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet sistemit të menaxhimit të pasurive rrugore, me synim privatizimin plotësisht të shërbimeve deri në vitin 2011.
- **Aviacioni civil:** Rritja e eficiency së Transportit Ajror në levizjen e lirë të njerezve dhe të mallrave. Arritja e standarteve të plotë evropiane të liberalizimit të tregut, nëpërmjet aplikimit të kushteve të barabarta të konkurrencës. Përfundshmëria e plotë me standartet ndërkombëtare për sigurinë dhe parrezikshmërinë në levizjen e pasagjereve dhe të mallrave. Kooperimin me të gjithë strukturat e transportit brenda dhe jashtë vendit për zhvillimin e turizmit, biznesit dhe bashkëpunimeve rajonale.
- **Ujesjelles kanalizime:** Të sigurojë furnizimin me ujë të pandërprerë në zonat urbane pas vitit 2015. Deri në muajin qershor të vitit 2007 parashikohet të përfundojë procesi i decentralizimit dmth transferimi i plotë i ndërmarrjeve të ujesjelles kanalizimeve pranë pushteteve vendore. Deri në vitin 2010 do të rritet aksesin në sistemin e ujesjellesit për popullsinë në zonat urbane deri në 85%. Deri në vitin 2012 do të rritet përqindja e popullsisë që do të jetë e lidhur me rrjetin ujesjelles 87%. Të përmirësojë infrastrukturën ekzistuese të ujesjelles kanalizimeve 92% në vitin 2015 me anë të investimeve në ndërtimin dhe rehabilitimin e sistemeve të ujesjelles kanalizimeve. Të bëhet përafrimi i kostos së prodhimit të ujit me çmimin e shitjes së tij të konsumatorit. Të ulen subvencionet në masën 8% për çdo vit. Të rrisë aksesin në sistemin e kanalizimeve për popullsinë e zonave urbane deri në masën 85%
- **Strehimi dhe urbanistika:** Të sigurojë akses në strehim të përshtatshëm për grupe të ndryshme të shoqërisë. Për këtë synohet që të sigurohet një inventar banesash sociale me qira që përbën 0.5% të stokut ekzistues të banesave, dhe të jetë i sigurt ndërtimi i rreth 5000 apartamenteve me kosto të ulët, në bashkëpunim me sektorin privat. Të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm të vendbanimeve njerëzore, nëpërmjet hartimit të studimeve rajonale dhe plane rregulluese të rreth 60% të territorit të vendit deri në vitin 2015. Rishikimi dhe hartimi i standarteve të reja të politikave mbi aksesin në strehim dhe mirëmbajtjen e banesave.
- **Planifikimi i Territorit:** Kërkon të sigurojë optimizimin e përdorimit të tokës dhe burimeve natyrore në baza të qëndrueshme. Ai i referohet metodave të përdorura gjerësisht nga sektori publik për të influencuar në shpërndarjen e ardhshme të aktiviteteve në një territor të caktuar, gjithashtu synon krijimin e një organizmi hapësor më racional të përdorimeve të tokës dhe të lidhjeve ndërmjet tyre për të balancuar kërkesat për zhvillim me nevojën për të mbrojtur ambientin dhe për të arritur objektiva sociale dhe ekonomike.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

Qëllimi i këtij programi është apdatimi i Teknologjise së Informacionit dhe në pergjithesi rinovimi i pajisjeve te MPPTT. Gjithashtu MPPTT-ja ben dhe mirembajtjen e rrjeteve të të gjithë Ministrive, në kuadër të e-government.

3.2 RRJETI I RRUGEVE NACIONALE

Politika e ketij programi konsiston ne zhvillimin dhe rehabilitimin e rrjetit rrugor kombetar, kompletimin e korridoreve rrugore kombetare, permiresimin e rrugeve nderkufitare dhe i rrugeve turistike, si dhe permiresimin e mirembajtjes dhe te sigurise se qarkullimit rrugor, duke synuar integrimin dhe arritjen e standardeve te njohura nderkombetare dhe te BE-se.

3.3 TRANSPORTI RRUGOR DHE SIGURIA RRUGORE

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin ligjor, me qëllim përafrimin e legjislacionit të vendit, me atë komunitar. Kjo do të realizohet nëpërmjet ndryshimeve të duhura në aktet ligjore, nxjerrjes së Akteve ligjore dhe nënligjore si dhe ratifikimit të konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në këtë fushë. Krijimi i një sistemi rregullator ligjor, në përputhje të plotë me zhvillimin ekonomik të vendit, sigurimi i shërbimeve optimale të transportit dhe sigurisë rrugore. Aplikimi i normave dhe standardeve evropiane në shërbim të sigurisë së lëvizjes së përdoruesve të rrugës do të ketë për qëllim parandalimin dhe minimizimin e aksidenteve rrugore.

3.4 PORTET

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e infrastrukturës dhe superstrukturës së nevojshme, privatizimin e shërbimeve komerciale, rritjen e efektivitetit dhe orientimin nga ekonomia e tregut. Gjithashtu, konsiston në rritjen e standardit të anijeve, sigurisë së navigacionit dhe në facilitetet portuale.

3.5 HEKURUDHAT

Politika e këtij programi konsiston fillimisht në përmirësimin e kushteve teknike të infrastrukturës hekurudhore, të shërbimit të transportit të udhëtarëve dhe rritjen e volumeve të transportit të mallrave me anë të përmirësimit të treguesve tekniko-financiar dhe ekonomik të këtij sektori. Gjithashtu, kjo politikë synon krijimin e kushteve konkurruese në pjesëmarrjen e këtij tregu transporti në atë rajonal nëpërmjet përafrimit të legjislacionit me atë evropian si dhe mundësive reale për bashkëpunim dhe zhvillim transporti me vendet kufitare. Në këtë kuadër rëndësi parësore për programet buxhetore në sektorin e hekurudhës merr ristrukturimi i administrimit të saj.

3.6 AVIACIONI CIVIL

Politika e ketij programi konsiston në: krijimin e një tregu konkurrues, jo diskriminues, të liberalizuar, për sa i përket shërbimeve te operimit te transportit ajror, me synim rritjen e levizjes se lire te pasagjereve dhe mallrave; zhvillimin e transportit te brendeshem ajror rme synim arritjen e standarteve evropiane nepermjet pershtatjes se infrastruktures ligjore dhe operuese ne kete fushe; përmirësimin dhe njehsimin e kushteve dhe rregullave të operimit, të sigurisë dhe parrezikshmërisë, administrimit të hapësirës ajrore dhe mbrojtjes se mjedisit; dhe zbatimin e marrëveshjeve të Shqiperise me KE (Marreveshja ECAA dhe Marreveshja Horizontale).

3.7 UJESJELLES KANALIZIME

Politika e këtij programi konsiston në zhvillimin e infrastruktures ujesjelles kanalizime për krijimin e shërbimeve efikase të ujit dhe të sanitetit, të krahasueshme me standartet Europiane, në zonat urbane dhe rurale. Kjo do të arrihet nëpërmjet kryerjes së disa reformave në sektor si: reforma e menaxhimit (menaxhimi i kërkesës, monitorimi dhe krahasimi, kualifikimi i personelit, krijimi i kapaciteteve në sektorin e ujit dhe të sanitetit); reforma ligjore (për procesin e decentralizimit dhe dhenien e kompetencave autoriteteve lokale, ndërgjegjesimi publik dhe programi i komunikimit, reforma e pjesëmarrjes së sektorit privat) dhe institucionale (ndryshimi i rolit të Qeverisë në sektor nga sigurues shërbimi në politike-bërës, rregullues dhe lehtësues), reforma financiare, reforma e zbutjes së varferisë si dhe reforma teknike.

3.8 STREHIMI DHE URBANISTIKA

Politika e këtij programi konsiston në përmirësimin ligjor, financiar dhe institucional të mjedisit për zhvillimin e strehimit dhe zhvillimit urban nëpërmjet sudimeve, rregullimeve ligjore e ofrimit të strehimit në veçanti për familjet me të ardhura të ulta dhe realizimit të skemave të partneritetit shtet privat. Gjithashtu politika e këtij programi buxhetor konsiston edhe në asistencë për përgatitjen e studimeve pjesore urbanistike, planeve rregulluese të ndryshme njësisive vendore dhe studime të qëndrave të qyteteve.

3.9 SHËRBIMET PUBLIKE

Në këtë program përfshihet mbështetja buxhetore për Policinë Ndërtimore, në zbatimin e ligjit në rastet e shkeljes së planeve urbanistike, nga ndërtimet abuzive.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrohet produktet të mëposhtme në 2007. Këto produktet konsistojnë Plani i Monitorimit të Ministrisë.

4.1 RRJETI I RRUGEVE NACIONALE

Objektivat e politikës

- Vazhdimi i ndertimit të segmentit Milot-Rreshen 26 km, financim i Bankes Botërore (\$25 milion) dhe i Qeverisë Shqiptare
- Përgatitja e projektit të zbatimit dhe fillimi i ndertimit të segmentit Rreshen-Reps-Kalimash 60 km, financim i Qeverisë Shqiptare dhe financim të huaj (hua)
- Vazhdimi i punimeve të ndertimit në segmentin Kalimash-Kukes-Morinë 28 km, si dhe në segmentin Shkoder-Hani i Hotit 39 km
- Ndertimi i segmentit Lushnje-Fier 21.5 km, financim i Qeverisë Italiane (€24 milion) dhe i Qeverisë Shqiptare
- Vazhdimi i ndertimit të rruges Transballkanike Vlore, financim i buxhetit të shtetit rreth 750 milion leke.
- Përfundimi i projektit të mirëmbajtjes së rrugëve të financuar nga Banka Botërore dhe GoA, rritja e mbështetjes buxhetore të mirëmbajtjes dhe zbatimi në 2 prefektura pilot të sistemit të mirëmbajtjes, bazuar në kontrata performancë.
- Vazhdimi i ndertimit të rrugëve turistike të plazhit të Divjakes, Fier-Seman (plazh), Lac-Patok, si dhe të rruges së bregdetit Jug-Perëndimor.

Produktet që do të ofrohen

- Përmirësimi i akseve kombëtare ekzistues, duke nderhyrë për eliminimin e rreshqitjeve në zona të ndryshme, të cilat përveçse paraqisin rrezikshmëri për aksidente fatale, krijojnë edhe anomali në qarkullimin e mallrave dhe udhëtarëve në disa nga arteriet kryesore të vendit, siç mund të jenë: rrëshqitjet në aksin Tirane-Elbasan-Qafe Thane, Tirane-Ndroq-Plepa, Milot-Ulez-Burrel, Shkoder-Puke-Fushe Arrez, Berat-Skrapar, Fier-Ballsh-Tepelene, Vlore-Orikum-Llogara etj.
- Vazhdimi i ndërhyrjeve me sistemim-asfaltim në zonat me të dëmtuara të akseve kryesore të vendit, si Tirane-Elbasan, Pogradec-Korçë, Milot-Klos-Peshkopi, Vau Dejës-Puke-Fushe Arrez, Rreshen-Fushe Arrez, rruga e Komanit, rruga Fierze-Bajram Curri etj. Me këto investime, brenda vitit 2007, do të përfundojnë punimet me riveshje dhe sistemim-asfaltim në rreth 80 km rrugë të akseve rrugore kryesore kombëtare.
- Plotësimi i rekomandimeve të raporteve përkatës të Komisionit Evropian, si dhe të Bankes Botërore për vazhdimin e punës së nisur për përmirësimin e sigurisë rrugore, nëpërmjet projekteve të veçante të plotësimit me sinjalitike rrugore dhe ndertimit të barrierave mbrojtëse në akse të rëndësishme të vendit, si: Mjeda-Puke-Fushe Arrez, Jergucat-Sarandë-Butrint, Durres-Rrogozhinë, ndriçimi i superstradës Vore-Durres dhe i rrethrotullimeve të superstradës Rrogozhinë-Lushnje, etj.
- Përfundimi i projektit të mirëmbajtjes së rrugëve, financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare dhe fillimi i kontratave të performancës.
- Hartimi dhe miratimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit të "Standardeve Shqiptare të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve" (referuar normativave të KE-së me financim të delegacionit Evropian CARDS prej €598,086, dërgimi në KM dhe hyrja në fuqi në 6 muhorin e dytë 2007. Përmirësimi cilësor në hartimin e projekteve dhe ndërtimin e rrugëve në kushtet ekonomike dhe fizike të vendit).

- Zbatimi i Planit Kombëtar të Transportit dhe përditësimi i vazhdueshëm për pjesën e zhvillimit të infrastrukturës rrugore, përfshi planifikimin e investimeve dhe buxhetimin për asetet e mirëmbajtjes rrugore (Përmirëson zbatimin e prioriteteve të programit të rrjetit rrugor kombëtar, përmirëson menaxhimin e investimeve publike përfshi identifikimin, aprovimin dhe vlerësimin e projekteve të infrastrukturës rrugore, në periudhën e hartimit të projekt-buxhetit për vitin pasardhës).
- Rishikimi i klasifikimit për një pjesë të rrugëve dytësore, aktualisht në administrim të DPRR-së, si rrugë kombëtare, për t'u riklasifikuar si rrugë lokale (Rreth 1000 km rrugë dytësore, nga kombëtare mund të riklasifikohen si rrugë lokale në administrim të njësive vendore. Studimi dhe përgatitja e propozimit nga DPRR-ja në bashkëpunim me Grupin e Asistencës Teknike të MPPTT-së dhe Drejtorinë e Politikave Transportit Rrugor, dërgimi dhe hyrja në fuqi e VKM-së në 6muajorin e dytë 2007. Riklasifikimi parashikon kurse në shpenzime, si rezultat i zbatimit të një standardi tjetër për rrugët e kësaj kategorie)

4.2 MENAXHIMI I TRANSPORTIT

Objektivat e politikës

- Zbatimi i programit të investimeve për përmirësimin e kushteve të sigurisë rrugore si në drejtim të infrastrukturës rrugore ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të kontrollit teknik të mjeteve
- Kualifikimi i drejtuesve të mjeteve apo shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me qarkullimin e mjeteve
- Përafrimi i legjisllacionit në këtë fushë me vëmendje kryesore në sigurinë rrugore dhe ndotjen e mjedisit nga mjetet
- Vendosja e standarteve në nxjerrjet e gazrave nga automjetet e rënda dhe në nivelin e zhurmave, si dhe krijimin e një sistemi informimi mbi trafikun rrugor do të synojnë rritjen e sigurisë rrugore
- Krijimi i një sistemi rregullator dhe ligjor sipas kërkesave dhe standarteve evropiane që do të garantojë operime optimale të shërbimeve të transportit në bazë të një konkurimi të nivelit të lartë si dhe uljen e barrierave jo-fizike
- Në zbatim të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit për fushën e transportit rrugor, do të forcohet legjisllacioni për shmangien e konkurrencës së pandershme, si dhe do të zbatohen me rigozitet marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe në transportin rrugor
- Do të harmonizohet legjisllacioni shqiptar me atë të BE për sa i përket peshave dhe dimensioneve, kontrolleve në anë të rrugës, transportit të mallrave të rrezikshme dhe trajnimit të personelit të transportit rrugor, veçanërisht në lidhje me këtë të fundit. Ky proces do të shoqërohet me kryerjen e një studimi me qëllim njohjen me legjisllacionin komunitar në fushën e transportit rrugor si dhe me një sërë trajnimesh që do të forcojnë kapacitetet administrative të eksperteve në këtë fushë.

4.3 PORTET

Produktet që do të ofrohen

- Gjatë këtij viti do të punohet në drejtim të përmirësimit të kushteve të sigurisë detare, veçanërisht në drejtim të shkallës së ndalimit të anijeve shqiptare në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual (Paris). Për këtë qëllim, do të hartohet dhe miratohet projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Memorandumin.

- Në përputhje me këtë ligj do të ngrihet Kontrolli Shtetëror Portual, i cili do të jetë njësi kryesore për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Memorandumi. Kapitaneria e Përgjithshme e Porteve është institucioni përgjegjës për ngritjen e këtij organizmi.
- Në vazhdim të përpjekjeve për rritjen e sigurisë në porte dhe në përgjigje të angazhimeve që rrjedhin nga aderimi i Shqipërisë në Memorandumin e Mirëkuptimit për Kontrollin Shtetëror Portual dhe në konventa të tjera ndërkombëtare, do të krijohen gjithashtu:
 - Forca e Sigurisë në Portin e Sarandës
 - Forca e Sigurisë në Portin e Vlorës
 - Forca e Sigurisë në Portin e Shëngjinit
- Gjithashtu do të punohet në mënyrë sistematike për aderimin, ratifikimin e konventave ndërkombëtare dhe përafrimin e legjislacionit vendas me legjislacionin ndërkombëtar dhe atë të BE.

4.4 HEKURUDHAT

Produktet që do të ofrohen:

- Ristrukturimi i sistemit hekurudhor shqiptar është prioriteti i Qeverisë Shqiptare në fushën e transportit hekurudhor. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, duke synuar përputhjen e plotë të tij me atë evropian, përmirësimi i menaxhimit të performancës ekonomike, reduktimi i kostove operative, ulja e subvencioneve, përmirësimi i infrastrukturës hekurudhore si dhe rinovimi i përgjithshëm i inventarit të mjeteve lëvizëse, duke i dhënë përparësi importit të trenave rajonale, janë objektivat, që priten të realizohen. Qëllimi final është përfshirja e rrjetit tonë kryesor hekurudhor në rrjetet rajonale hekurudhore: “Korridorin VIII dhe Rrjeti Hekurudhor Rajonal i Performancës së Lartë”.
- Në zbatim të rekomandimeve të studimit “Plani Kombëtar për transportet” do të fundi nën konsulencën e huaj (Instituti Louis Berger) janë paraqitur për diskutim disa variante të strukturimit administrativ të Hekurudhave Shqiptare. Ky studim dhe rekomandimet e saj janë në fazën e studimit dhe diskutimit për përzgjedhjen më optimale në përputhje me Programin e Qeverisë në zbatim të MSA, të variantit përfundimtar të strukturimit administrativ të Hekurudhave Shqiptare. Kjo do të hapi jo vetëm rrugën e përmirësimit tekniko-ekonomiko-financiar të këtij sektori të transportit por do të krijojë mundësinë e një përputhshmërie më të afërt me legjislacionin evropian të të gjitha akteve nënligjore të planifikuara për hartim dhe zbatim në vitin në vazhdim dhe në të ardhmën.
- Në kuadër të krijimit të një Sistemi Hekurudhor të Shpejtësisë së Lartë, MPPTT ka parashikuar të realizojë brenda vitit 2010 (ka qenë parashikuar brenda vitit 2007 por për shkak të volumeve të punës në përkthimin e direktivave të mëposhtme dhe të kushteve të implementimit - të transfuzimit në legjislacionin tonë me anë të dy VKM mendojmë se do të jenë të mundshme brenda 2010) iniciativat e mëposhtme ligjore:
 - VKM “Për ndërveprimin e sistemit hekurudhor me shpejtësi të lartë” me qëllim përafrimin e pjesshëm me Direktivën 96/48/EC
 - VKM “Për ndërveprimin e sistemit hekurudhor me shpejtësi të lartë” me qëllim përafrimin e pjesshëm me Direktivën 2004/50/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, të 29 prillit 2004.
- Këto masa legjislative do të mbështeten nga një studim mbi identifikimin më të hollësishëm të legjislacionit evropian në këtë fushë dhe përafrimin e legjislacionit vendas me këtë të fundit.

4.5 AVIACIONI CIVIL

Produktet që do të ofrohen

- Krijimi i një tregu konkurrues, jo diskriminues i liberalizuar i shërbimeve të operimit të transportit ajror, me synim rritjen e lëvizjes së lire të pasagjereve dhe mallrave
- Optimizimi i elementeve të dobishëm të transportit si shpejtësia dhe komoditeti i lëvizjes, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve përpunuese në aeroportin ndërkombëtar “Nene Tereza” duke ndjekur dhe supervizuar zbatimin e Kontratës së Koncesionit të Aeroportit të Rinasit (faza B ligji 9312, dt. 11.11.2004 “Marrëveshja e Koncesionit”)
- Modernizimi i administrimit të trafikut ajror, nëpërmjet zbatimit të Master Planit të Trafikut Ajror dhe perfundimi i fazes së III të Kontrates së Modernizimit të Trafikut Ajror deri 2010
- Studimi i zhvillimit të trafikut në aeroportin e Kukësit dhe të zonës Vlorë-Sarandë (VKM 864, dt. 20.12.2006)
- Zbatimi i dispozitave të Marrëveshjes Horizontale dhe Marrëveshjes Shumëpalëshe (ECAA) me KE
- Përgatitja e draftit përfundimtar të Kodit Ajror (sipas rekomandimeve të eksperteve të EUROCONTROL) dhe hartimi i projektligjit për miratimin e tij
- Transformimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil në Autoritet të Aviacionit Civil
- Krijimi i Entit të Investigimit të Incidenteve dhe Aksidenteve të Aviacionit
- Studime: Anekset e ICAO-s, Konventa e Çikago-s, Konventat dhe Protokollet ndërkombëtare të Aviacionit Civil
- Përmirësim të thellë të kuadrit dhe sistemit rregullator të transportit ajror nëpërmjet hartimit të akteve ligjore në përputhje të plotë me rregulloret dhe direktivat e KE dhe standartet ndërkombëtare në fushën e aviacionit
- Aderimime të drejta të plota në JAA dhe EASA (Agjencia Europiane e Sigurisë së Aviacionit)

4.6 UJESJELLES KANALIZIME

Produktet që do të ofrohen

- Do të përfundojë transferimi i ndërmarrjeve të ujës-jellës-kanalizimeve në pronësi të njërive vendore.
- Zbatimi i fatures së ujit dhe KUZ si titull ekzekutiv.
- Do të rritet aksesimi i popullatës nëpërmjet investimeve të buxhetit të shtetit apo ato me financim të huaj në zonat urbane në sistemin e furnizimit me ujë në masën 80% dhe për zonat rurale parashikohet furnizimi me ujë deri në masën 65%. Kështu për vitin e parë janë parashikuar të investohen rreth 1,929 milion leke që do të përmirësojë furnizimin me ujë për rreth 623 000 banorë.
- Do të rritet aksesimi i popullatës në zonat urbane dhe rurale për tu lidhur me sistemin e KUZ për zonat urbane 75% dhe ato rurale në masën 50%.
- Subvencionimi i ndërmarrjeve të ujës-jellësave për të bërë të mundur mbulimin e diferencës që është midis kostos së prodhimit dhe atij të shitjes. Kjo do të bëhet nëpërmjet një monitorimi mbi bazën e të cilës do të bëhet vlerësimi i tyre për dënimin e subvencioneve.

4.7 STREHIMI DHE URBANISTIKA

STREHIMI

Objektivat e politikës

- Plotësimi dhe hartimi i bazës së re ligjore, mbi programet sociale dhe mirëmbajtjen e banesave
- Zhvillimi i skemave të bashkëpunimit me sektorin privat ndërtues dhe bankar

- Nenshkrimi i marreveshjes dhe fillimi i projektit pilot për banesat sociale me qera
- Mbeshtetja e aktivitetit të EKB-se për sigurimin e banesave me kosto të ulët
- Ngritja e kapaciteteve vendore

Produktet që do të ofrohen

- 224 apartamente me kosto të ulët të përfunduara
- Një studim i kryer për ndërtimin e apartamenteve nepermjet partneritetit shtet-sektor privat

PLANIFIKIMI I TERRITORIT

Objektivat e politikës në fushën e planifikimit të territorit konsistojnë si më poshtë:

- Hartimi i politikave të planifikimit hapësinor, bashkëpronësisë dhe vlerësimit të taksimit të pasurisë së paluajtshme mbi vlerën e tregut që do të shërbejnë si bazë e hartimit të kuadrit të ri ligjor, në përputhje me programin e qeverisë.
- Hartimi, plotësimi dhe përmirësimi i bazës së re ligjore në fushën e planifikimit hapësinor, kontrollit të territorit, bashkëpronësisë dhe vlerësimit të taksimit të pasurisë së paluajtshme mbi vlerën e tregut
- Hartimi i Planit të Veprimit financiar dhe institucional, i cili parashikon impaktin financiar të reformës së planifikimit si dhe do të propozojë reformën institucionale më të përshtatshme
- Ngritja e kapaciteteve institucionale të MPPTT dhe të njësisë vendore
- Ndergjegjësimi i politikbërësve, sektorit privat dhe publik përsa i përket çështjet e planifikimit urban

Produktet që do të ofrohen

- Asistencë për përgatitjen e Masterplaneve, Studimeve dhe Planeve të Përgjithshme Rregulluese të qyteteve dhe zonave të parashikuara nga projektet e ndryshme me donatorë të huaj dhe nga buxheti i shtetit.
- Ngritjen e një sistemi të kompjuterizuar për taksimin dhe vlerësimin e pronës (GIS) pranë njësisë vendore

LEGALIZIMI I ZONAVE INFORMALE

Objektivat e politikës

